



Viti i XVI-të i Botimit, Nr.2

Dhjetor 2024

NGARKIMI I MENJËHERSHËM I IMPLANTEVE NUCLEOSS T6 NË MAKSILË: RAPORT – RAST KLINIK

Genc Zenunaj* Daniele Iannaci **, Erda Qorri ***

**Departamenti i Stomatologjisë, Specializimi "Kirurgji Orale" Albanian University, Tirana,*

***TRIAdontics Academy, Amsterdam, The Netherlands*

****Centro Odontoiatrico Bravetta – IDS, Klinikë Private, Romë, Itali*

Përmbledhje

Ngarkimi i menjëhershëm i implanteve dentare në maksilën atrofike ka shënuar përparime të rëndësishme në rehabilitimin e harkut të plotë. Heqja e dhëmbëve kur është nevoja dhe vendosja e urës fike brenda dite është një standart i ri estetik dhe funksional i cili qdo ditë po kërkohet më shumë. Ky raport klinik përshkruan një rezultat të suksesshëm duke përdorur implante NucleOSS T6 Torque, te një pacient që kishte nevojë për heqjen e pesë dhëmbëve dhe vendosjen e menjehershme të urës fikse të perkohshme (brenda 48 orëve). Protokollet kirurgjike dhe protetike, rezultatet klinike dhe ndjekja afatgjatë demonstrojnë jo vetëm mungesë humbjeje të kockës pas vendosjes së implanteve, por edhe rritje të saj mbi implantet.

IMMEDIATE LOADING OF NUCLEOSS T6 IMPLANTS IN THE MAXILLA: CLINICAL CASE REPORT

Abstract

Immediate loading of dental implants in the atrophic maxilla has marked significant advances in full-arch rehabilitation. Extraction of teeth when necessary and placement of a fixed bridge within the same day is a new aesthetic and functional standard that is increasingly being sought after. This clinical report describes a successful outcome using NucleOSS T6 Torque implants, in a patient who required the extraction of five teeth and immediate placement of a temporary fixed bridge (within 48 hours). The surgical and prosthetic protocols, clinical outcomes, and long-term follow-up demonstrate not only a lack of bone loss after implant placement, but also bone growth over the implants.

Hyrje

Ngarkimi i menjëhershëm në implantologji dentare ka transformuar rehabilitimin e harkut të plotë duke reduktuar kohën e trajtimit dhe duke ofruar përfitime të shpejta funksionale dhe estetike. Koncepti kërkon planifikim të kujdesshëm, stabilitet primar të lartë dhe zbatim të saktë protetik. Ky raport diskuton një rast të realizuar me imazheri CBCT, ekzekutim të saktë kirurgjik dhe rehabilitim protetik të menjëhershëm, duke treguar efektivitetin e teknikave moderne të implantologjisë.

Prezantimi i Rastit

Historiku i Pacientit:

Pacienti I gjinisë mashkull, ASA 1, 55-vjeçar u paraqit me një urë maksilare të ankoruar mbi pesë dhëmbë të dëmtuar. Pas vlerësimit klinik dhe radiografik duke përdorur CBCT nga Sirona, u finalizua plani i trajtimit. Pacienti ishte me shëndet të mirë sistemik, pa kundërrindikacione për kirurgji implanti.

Plani i Trajtimit:

1. Heqja e pesë dhëmbëve që mbështesnin urën (heqja e të gjithë dhëmbëve në maksillë)
2. Vendosja e tetë implanteve NucleOSS T6 Torque në maksilë.
3. Ngarkimi i menjëhershëm i gjashtë implanteve me një urë të përkohshme PMMA.
4. Rehabilitimi përfundimtar me një urë zirkoni pas katër muajsh.

Materiale dhe Metoda

Vlerësimi Paraprak:

- CBCT nga Sirona ofroi imazhe të detajuara 3D të maksilës për planifikimin e implantit.
- Vëllimi i kockës, cilësia dhe pikat referuese anatomike u analizuan me kujdes.

Protokolli Kirurgjik:

- U administrua anestezi lokale, e ndjekur nga heqja atraumatike e pesë dhëmbëve.
- U krye kyretazh i gjerë dhe nivelim i kockës për të përgatitur vendin kirurgjik.
- U vendosën tetë implante NucleOSS T6 Torque, duke arritur një stabilitet primar me moment torsioni mbi 45 Ncm për shtatë implante. Një implant (Regjioni 15) nuk u arrit torku I kërkuar dhe nuk u përfshi në ngarkimin e menjëhershëm.
- U vendosën multiunite për të mbështetur fazën protetike.

Protokolli Protetik:

- Marrja e masës me A-silikon nga brendi Zermach, me metoden me transfer të hapur, dhe lidhja me kujdes e open-transferëve, vendosja e ruberdamit për të ruajtur suturat dhe plagen gjatë marrjes së masës.
- Ura e përkohshme PMMA u përgatit brenda 12 orëve, por u dorzua në gojë për 48 orë me

kërkesën e pacientit.

- Pas dy muajsh, ura e përkohshme nag PMMA u thye, por u zëvendësua brenda ditës me një urë të re nga i njëjti material, urë e cila qëndroi pa demtime deri në dorzimin e punimit përfundimtar.
- Ura përfundimtare nga zirkoni (Oroident) e tipit ‘screwed u dorëzua pas shtatë muajsh.

Rezultatet Klinike

Ngarkimi i menjëhershëm i pesë implanteve u realizua pa komplikime të mëdha. Rezultatet kryesore përfshijnë:

- **Komoditeti i Pacientit:** Dhimbje dhe ënjtje minimale pas operacionit.
- **Radiografi dhe Analiza Klinike:** Radiografitë panoramike pas katër dhe gjashtë muajsh treguan mungesë humbjeje të kockës. Në mënyrë të jashtëzakonshme, u vërejt rritje e kockës mbi implantet, duke dëshmuar osseointegrim të shkëlqyeshëm.
- **Stabiliteti Protetik:** Ura e përkohshme PMMA, megjithëse pësoi thyerje pas dy muajsh, u zëvendësua shpejt dhe siguroi funksion të shkëlqyer gjatë fazës së shërimit, pa komplikime të tjera.

Diskutim

Ngarkimi i menjëhershëm kërkon zgjedhjen e kujdesshme të vendeve të implanteve, teknika të sakta kirurgjikale dhe stabilitet të lartë primar. Ky rast tregon se edhe në rehabilitimet komplekse të harkut të plotë, implantet moderne si NucleOSS T6 Torque ofrojnë rezultate të parashikueshme.

- **Reagimi i Kockës:** Mungesa e humbjes së kockës dhe rritja e saj mund t’i atribuohet teknikave atraumatike kirurgjikale dhe vetive biomekanike të sistemit të implantit, dhe ndoshta me rëndësishmja sipas mendimit të autorit të këtij rasti klinik është okluzioni I balancuar.
- **Pajtueshmëria e Pacientit:** Edukimi i duhur dhe ndjekja e protokolleve të mirëmbajtjes kontribuan në suksesin afatgjatë të trajtimit.

Rezultatet përputhen me literaturën ekzistuese për ngarkimin e menjëhershëm, duke shtuar të dhëna të vlefshme për performancën e sistemit NucleOSS T6 Torque.

Përfundim

Ky rast klinik nënvizon potencialin e ngarkimit të menjëhershëm për të arritur sukses funksional dhe estetik në rehabilitimin e harkut të plotë. Përdorimi i implanteve NucleOSS T6 rezultoi në stabilitet të shkëlqyer primar, mungesë të humbjes së kockës dhe rritje të saj gjatë ndjekjes gjashtë-mujore. Mirëmbajtja afatgjatë mbetet thelbësore për rezultate të qëndrueshme.

Referencat

1. Esposito, M., et al. (2007). "Immediate vs. delayed loading of dental implants: A Cochrane review." *Cochrane Database of Systematic Reviews*.
2. Ganeles, J., et al. (2014). "Immediate and early loading of implants in partially edentulous and completely edentulous jaws." *International Journal of Oral & Maxillofacial Implants*.
3. Misch, C. E. (2015). "Contemporary Implant Dentistry." Mosby.
4. Cochran, D. L., et al. (2004). "Consensus statements and recommended clinical procedures regarding loading protocols for endosseous dental implants." *International Journal of Oral & Maxillofacial Implants*.
5. Buser, D., et al. (1999). "Long-term stability of osseointegrated implants in augmented bone." *Clinical Oral Implants Research*.
6. Sanz, M., et al. (2015). "Implant therapy in the esthetic zone." *Periodontology 2000*.



Figura 1. Planifikimi fillestar





Figura 2. Grafia panoramike pas vendosjes së implanteve



Figura 3. Ura pas vendosjes në gojë pas 48 ore




Figura 4. Vensosja e urës perfundimtare në gojë



Grafia panoramike menjëherë pas implantmit



Grafia panoramike pas 4 muajve



Grafia panoramike pas vidosjes së urës – pas 6 muajve